



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.752/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.P.N “3L ING”, me seli në Prishtinë, Lagja Bregu i Diellit II, Objekti I, nr.6 me NRB:70534657, me NUI: 810881814 dhe me nr.Fiskal: 600005278 të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M., avokat nga Gjakova, ndaj debitorit N.N.P “Standard Plus” me seli në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.310/22 të datës 05.04.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit N.P.N “3L ING”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.310/22 i datës 05.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.310/22 të datës 05.04.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.N.P “Standard Plus” me seli në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, ka Anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.58/2020 të datës 02.03.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit me të cilën është kërkuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit kurse aktvendimi i atakuar të priset dhe ndryshohet në dobi të kreditorit, ashtu që refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit

dhe vërtetohet në tërësi si i bazuar urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat Fadil Hoxha nga Prishtina, P.nr.58/2020, i datës 02.03.2020, me të cilin është lejuar Propozimi për përmbartim i kreditorit, për përmbartimin e shumës 3,750.00€, dhe detyrohet debitori që kreditorit të ia paguaj borxhin në shumë prej 3,750.00€, si dhe t'ia kompenzoj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në ankes ka parashtruar debitori me propozim që Dhomat e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e kreditorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.310/22 i datës 02.04.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.N “3L ING”, me seli në Prishtinë, me datën 02.03.2020 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit N.N.P “Standard Plus” me seli në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 3,750.00€ me kamatë ligjore dhe shpenzime të përmbartimit.

Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.N “3L ING”, ka caktuar urdhrin P.nr.58/2020 të datës 02.03.2020 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm , përkatësisht faturave: nr.2/2019 të datës 23.12.2019 dhe faturën 01/2019 të datës 10.06.2019, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ja paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 3,750.00€, me kamatë ligjore dhe shpenzime të procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.310/22 të datës 05.04.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.N.P “Standard Plus” me seli në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.58/2020, të datës 02.03.2020,

të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, dhoma e shkallës së parë ka theksuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, ndërsa nga fletë kthesa postare e cila gjendet në shkresat e lëndës, nga e njëjta nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, nga fletë kthesa konstatohet nënshkrimi i marrësit i dorëzuesit, por të lloji i dërgesës nuk ka shënim se cilat dokumente janë dorëzuar por figuron vetëm dokumente, andaj gjykata në bazë të kësaj fletë kthesës nuk mund të konstatoj se ky dorëzim është i rregullt, në mungesë të shënimeve tek lloji i dërgesës, pra nuk mund të argumentohet se janë dorëzuar faturat apo ndonjë dokument tjetër tek debitori.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore apo kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit janë lëshuar në mënyrë të njëanshme dhe nuk përmbajnë as vulën as nënshkrimin e pranuesit, respektivisht nuk dëshmohet pranimi i rregullt i faturave nga pala debitore. Në këtë drejtim dhoma e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se faturat si dokumente të besueshme mbi të cilat ishte iniciuar procedura përmbare, respektivisht është lejuar përmbaremi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë komulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se faturat nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga ana e pranuesit – debitorit dhe të njëjtat nuk ka dëshmi se janë pranuar në mënyrë të rregullt, ashtu që propozimi për përmbaremi nuk i plotëson kushtet nga Neni 37 i LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbaremi paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbaremi dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbaremi janë tiparet e përmbaremi të dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbaremi sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaremi duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbaremi të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore se dorëzimi i faturave në selinë e debitorit ka ndodhur përmes fletë dërgesës postare vërtetuar në zyrën noteriale. Në këtë rast nuk gjen zbatim neni 103 i LPK-së, për ta konsideruar fakt të pranueshëm se debitori ka pranuar detyrimin nga faturat përmbaremi.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbaremi dhe Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaremi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.752/23 datë 07.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha